



CEZ SHPËRNDARJE SH.A

PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2011
(së bashku me raportin e audituesit të pavarur)

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR..... | 1 |
| PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE | 2 |
| PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE | 3 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT | 4 |
| SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE | 5 |
| 1. INFORMACION I PËRGJITHSHEM | 5 |
| 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RËNDËSISHME KONTABËL | 6 |
| 3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR | 16 |
| 4. VLERËSIMET KRITIKE DHE GJYKIME TË KONTABILITETIT | 20 |
| 5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE..... | 27 |
| 6. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE | 28 |
| 7. AKTIVE FINANCIARE..... | 29 |
| 8. INVENTARE | 29 |
| 9. LLOGARI TE ARKETUESHME | 29 |
| 10. TE TJERA TE ARKETUESHME | 30 |
| 11. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO..... | 31 |
| 12. HUAMARRJA | 32 |
| 13. LLOGARI TE PAGUESHME (FURNITORE) | 35 |
| 14. DETYRIME PER TAKSAT DHE SIGURIMET SHOQERORE..... | 35 |
| 15. DETYRIME TE TJERA AFATSHKURTRA | 36 |
| 16. PROVIZIONET..... | 36 |
| 17. SHITJA E ENERGJISE | 37 |
| 18. TE ARDHURA TE TJERA..... | 37 |
| 19. BLERJE E ENERGJISE ELEKTRIKE..... | 38 |
| 20. SHPENZIME TE PERSONELIT | 38 |
| 21. SHPENZIME TE TJERA, NETO | 38 |
| 22. SHPENZIMET FINANCIARE, NETO..... | 39 |
| 23. INFORMACION MBI PALET E LIDHURA | 40 |
| 24. LLOGARITJA E TATIMIT MBI FITIMIN..... | 41 |
| 25. MENAXHIMI I KAPITALIT..... | 44 |
| 26. ANGAZHIMET DHE DETYRIMET E KUSHTEZUARA..... | 45 |
| 27. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT | 45 |

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR PËR AKSIONERËT E CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Ne jemi angazhuar për të audituar pasqyrat financiare të CEZ Shpërndarje sh.a. ("Shoqërisë"), që përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2011, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e fluksit të parasë dhe të ndryshimeve në kapital për këtë vit ushtrimor, dhe një përmbledhje të politikave kontabile dhe të tjera shënime sqaruese.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrole të brendëshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Megjithatë, për arsye të çështjeve që përshkruhen tek paragrafi për "Bazat e Refuzimit të Dhënies së Opinionit", ne nuk ishim në gjendje të siguronim të dhëna auditi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për dhënien e opinionit.

Bazat për Refuzimin e Dhënies së Opinionit

Pasqyrat financiare të përgatitura tregojnë që Shoqëria aktualisht ka një gjendje kapitali negative dhe bazuar në informacionet shpjeguese të shënimit 4.2 të pasqyrave financiare situata dhe rrethanat aktuale financiare janë jo të qëndrueshme dhe e ekspozojnë Shoqërinë ndaj një mjedisi ekonomiko-ligjor ku veprimet e ardhshme të mundshme janë të paparashikueshme. Ka disa pasiguri që lidhen me planin e masave të mundshme për të ardhmen e Shoqërisë të cilat mund të ndikojnë në menyrë materiale prezantimin aktual të pasqyrave financiare dhe të vështirësojnë vlerësimin e këtij efekti, si për shembull paaftësia e mundshme jolikujduese e Shoqërisë, efekti i çështjeve ligjore dhe pasojat e kuadrit ligjor, heqja e liçensës së shpërndarjes së energjisë dhe mundësia për vazhdimin e dhënies së këtij shërbimi, apo aftësia për të marrë fonde të tjera shtesë që të arrijnë të përmbushin pagesën e detyrimeve brenda afateve dhe kërkesat e tjera rregullatore.

Drejtimi i Shoqërisë nuk ka përgatitur një vlerësim të detajuar mbi parimin e vijimësisë, edhe pse Pasqyrat Financiare janë përgatitur me këtë bazë. Ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për vijuar aktivitetin e saj duke qenë se nuk ishim në gjendje të kryenim procedura auditimi alternative për të. Rrjedhimisht, efektet e mundshme të anomalive të paidentifikuara që lidhen me vlerësimin e parimit të vijimësisë në pasqyrat financiare, nëse ka, mund të jenë materiale dhe të përhapur.

Refuzim i dhënies së Opinionit

Për shkak të rëndësisë së çështjes së përshkruar në paragrafin për "Bazat e refuzimit të dhënies së opinionit", ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencë të nevojshme të auditimit për të bazuar opinionin tonë. Rrjedhimisht, ne nuk shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare.

Theksim i Çështjeve

Pa lëshuar një opinion, tërheqim vëmendje ndaj Shënimit 5 të pasqyrave financiare, i cili përcakton se çertifikatat e pronësisë së tokave dhe ndërtesave të Shoqërisë që duhet të tranferoheshin nga KESH gjatë momentit të shpërndarjes së Shoqërisë ende nuk janë finalizuar. Rrjedhimisht, këto toka dhe ndërtesa nuk janë regjistruar në mënyrë të rregullt në Regjistrin e Hipotekës.

Ernst & Young Certified Auditors Shpk, Skopje-Tirana Branch

Ernst & Young Certified Auditors Shpk

14 Dhjetor 2012
Tiranë, Albania

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.*(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

më 31 Dhjetor 2011

| | Shenime | 31-Dhj-11 | 31-Dhj-10 |
|--|---------|--------------------|-------------------|
| AKTIVET | | | |
| Aktive afatgjata | | | |
| Aktive afatgjata materiale | 5 | 26,934,505 | 28,885,564 |
| Aktive afatgjata jomateriale | 6 | 99,032 | 25,956 |
| Aktive financiare | 7 | 10,949 | 12,282 |
| | | 27,044,486 | 28,923,802 |
| Aktivet afatshkurtra | | | |
| Inventaret | 8 | 625,123 | 1,086,556 |
| Llogari te arketueshme tregtare, neto | 9 | 12,839,134 | 6,904,398 |
| Te tjera te arketueshme, neto | 10 | 395,075 | 339,341 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 11 | 345,523 | 510,241 |
| Te ardhura te perlllogaritura | | 4,123,759 | 1,638,980 |
| Parapagimet per tatim fitimin | 24 | 1,096,201 | - |
| | | 19,424,815 | 10,479,516 |
| Totali i aktiveve | | 46,469,301 | 39,403,318 |
| KAPITALI | | | |
| Kapitali dhe rezerva te disponueshme per aksioneret | | | |
| Kapital aksionar | | 30,099,102 | 30,099,102 |
| Rezerva te tjera | | 2,916,011 | 2,916,011 |
| Humbje te akumuluar | | (30,320,781) | (24,968,464) |
| Te ardhura neto vjetore | | (4,487,066) | (5,352,317) |
| Kapitali total | | (1,792,734) | 2,694,332 |
| DETYRIMET | | | |
| Detyrimet afatgjata | | | |
| Huate afatgjata neto | 12 | 17,027,473 | 12,564,745 |
| Provizione | 16 | 12,123 | 12,123 |
| | | 17,039,596 | 12,576,868 |
| Detyrimet afatshkurtra | | | |
| Llogarite e pagueshme | 13 | 14,711,408 | 9,808,719 |
| Detyrimet per taksa dhe sigurimet shoqerore | 14 | 426,695 | 216,685 |
| Tatimi mbi te ardhurat | 23 | - | 523,219 |
| Pjesa afatshkurter e huave afatgjate | 12/b | 1,281,456 | 1,529,377 |
| Huate afatshkurtra | 12/c | 5,160,237 | 8,436,102 |
| Detyrime te tjera afatshkurtra | 15 | 4,102,804 | 2,048,174 |
| Provizione | 16 | 5,539,839 | 1,569,842 |
| | | 31,222,439 | 24,132,118 |
| Detyrimet totale | | 48,262,035 | 36,708,986 |
| Total i kapitalit dhe detyrimeve | | 46,469,301 | 39,403,318 |

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.*(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**

për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011

| | Shenime | <u>31-Dhj-11</u> | <u>31-Dhj-10</u> |
|--|---------|---------------------|---------------------|
| Te ardhurat | 17 | 45,493,597 | 41,808,400 |
| Te ardhura te tjera | 18 | 429,599 | 380,948 |
| Te ardhurat operative | | 45,923,196 | 42,189,348 |
| Energjia e blere | 19 | (21,873,203) | (21,193,983) |
| Tarifa e transmetimit | | (4,101,136) | (3,768,798) |
| Lende e pare dhe materiale konsumi te perdorura | | (1,113,694) | (794,348) |
| Shpenzime per personelin | 20 | (3,340,330) | (3,397,966) |
| Zhvleresimi dhe amortizimi | | (3,437,222) | (3,167,544) |
| Shpenzime te tjera | 21 | (14,978,189) | (11,813,116) |
| Shpenzimet operative | | (48,843,774) | (44,135,755) |
| Fitimi/ (humbja) operative | | (2,920,578) | (1,946,407) |
| Te ardhura financiare | 22 | 478,473 | 267,740 |
| Shpenzime financiare | 22 | (2,044,961) | (2,119,507) |
| Shpenzime financiare neto | 22 | (1,566,488) | (1,851,767) |
| Humbja perpara taksave | | (4,487,066) | (3,798,174) |
| Shpenzim Tatim fitimi | 24 | - | (1,554,143) |
| Humbja e vitit ushtrimor | | (4,487,066) | (5,352,317) |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese | | - | - |
| Totali i te ardhurave gjitheperfshirese | | (4,487,066) | (5,352,317) |
| Fitimi (humbja) neto per aksion (LEK per aksion) | | | |
| Fitimi baze per aksion | | (149) | (178) |
| Fitimi i pakesuar per aksion | | (149) | (178) |
| Numri mesatar i aksioneve | | | |
| Baze | | 30,099,102 | 30,099,102 |
| Pakesuar | | 30,099,102 | 30,099,102 |

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.*(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE**

për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011

| | 2011 | 2010 |
|--|--------------------|--------------------|
| Aktivitetet operative | | |
| Humbje per periudhen para tatimit mbi fitimin | (4,487,066) | (3,798,174) |
| Korrigjuar per: | | |
| Zhvleresim, amortizim, nxjerrjen jashte perdorimit | 3,437,222 | 3,167,544 |
| Humbjet(fitimet) nga kursi i kembimit valuator | 628,907 | 1,186,383 |
| Shpenzime interesi dhe te ardhura interesi | 697,171 | 551,022 |
| Vleresimi i rezervave, provizioneve dhe korrigjimeve te tjera | 9,428,413 | 9,531,295 |
| Ndryshimet ne kapitalin qarkullues: | | |
| Llogari te arketueshme | (14,615,592) | (10,608,952) |
| Materiale dhe furnizime | 461,433 | (321,497) |
| Aktive te tjera afatshkurtra | 707,898 | (325,937) |
| Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera | 6,652,498 | 2,966,150 |
| Aktive monetare te gjeneruara nga aktiviteti operativ | 2,910,884 | 2,347,834 |
| Tatimi mbi fitimin i paguar | (1,096,201) | (1,056,923) |
| Interesi i paguar | (637,552) | (605,384) |
| Interesi i arketuar | 5,715 | 29,123 |
| Aktive monetare neto gjeneruar nga aktiviteti operativ | 1,182,846 | 714,650 |
| Aktivite investuese | | |
| Shtesat ne AAGJM dhe ne aktive te tjera afatgjata | (3,569,992) | (1,929,853) |
| Flukese monetare hyrese nga shitja e aktiveve afatgjata | 2,010,752 | 73,957 |
| Aktive monetare neto perdorur ne aktivitetet investuese | (1,559,240) | (1,855,896) |
| Aktivitetet financuese | | |
| Flukese monetare hyrese nga huate | 5,103,658 | 4,944,891 |
| Pagesat e huave | (4,892,497) | (3,870,122) |
| Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese | 211,161 | 1,074,769 |
| Efkti neto nga diferenca e kurseve te kembimit | 515 | 12,359 |
| Ulja neto ne mjete monetare dhe ekuivalente | (164,718) | (54,117) |
| Mjete monetare dhe ekuivalente ne fillim te periudhes | 510,241 | 564,358 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente ne fund te periudhes | 345,523 | 510,241 |

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.*(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

| | Kapitali aksionar | Kontributi aksionar i paregjistruar | Rezerva te tjera | Humbje te akumuluar | Totali i kapitalit aksionar |
|----------------------------|-------------------|-------------------------------------|------------------|---------------------|-----------------------------|
| Gjendja me 31 Dhjetor 2009 | 30,099,102 | - | 2,916,011 | (24,968,464) | 8,046,649 |
| Te ardhura te tjera 2010 | - | - | - | (5,352,317) | (5,352,317) |
| Gjendja me 31 Dhjetor 2010 | 30,099,102 | - | 2,916,011 | (30,320,781) | 2,694,332 |
| Te ardhura te tjera 2011 | - | - | - | (4,487,066) | (4,487,066) |
| Gjendja me 31 Dhjetor 2011 | 30,099,102 | - | 2,916,011 | (34,807,847) | (1,792,734) |

Bordi i Drejtorëve të CEZ SHPËRNDARJE sh.a ka aprovuar këto pasqyra financiare, si edhe shënimet shpjeguese në faqet nga 5 deri në 46, më 14 Dhjetor 2012 dhe janë firmosur nga:



Ronald MARX
Drejtor Menaxhues

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Informacion i Përgjithshëm

CEZ Shpërndarje sh.a (ose "Shoqëria") është përgjegjësjë e vetme për shpërndarjen e energjisë elektrike në Shqipëri. CEZ Shpërndarje sh.a është aktualisht e organizuar në katër divizione: shitja, shpërndarja, financa dhe administrimi i përgjithshëm, si edhe në katër rajone të shpërndarjes: rajoni verior, rajoni qendror, rajoni juglindor dhe rajoni jugperëndimor.

Cez Shpërndarje u krijua si shoqëri aksionere më 19 qershor 2007, duke u bazuar në Vendimin nr. 862 të Këshillit të Ministrave, të datës 20 dhjetor 2006. Kjo Kompani u themeluar si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a ("KESH" ose "Kompania Mëmë") dhe filloi aktivitetin e saj operativ që prej 1 Janarit 2007.

Më 29 Maj 2009, CEZ a.s, selia e së ciles është e vendosur në Duhova 2 / 1444, 14074, 4 Pragë, Republika Çeke u bë pronar i 76% të aksioneve të Kompanisë.

24% të aksioneve mbeten në pronësi të Republikës së Shqipërisë, perfaqësuar nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes.

Bordi i Drejtorëve të CEZ Shpërndarje sh.a më 31 Dhjetor 2011, është i përbërë nga:

| | |
|-------------------|---------|
| Z. Josef HEJSEK | Kryetar |
| Z. Martin NEMECEK | Anëtar |
| Z. Ján IVAN | Anëtar |

Ju lutem referojuni shenimit shpjegues 27.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të CEZ Shpërndarje sh.a më 31 Dhjetor 2011 janë si vijon:

| | |
|-----------------------|------------|
| Z. Martin PACOVSKY | Kryetar |
| Znj. Michaela ŠIMKOVÁ | Nënkryetar |
| Z. Petr SEDLÁK | Anëtar |
| Z. Bohdan MALANIUK | Anëtar |
| Z. Petr MÍKOVEC | Anëtar |
| Z. Majlind Lazimi | Anëtar |

Z.Illir Ciko u zëvendësua nga Z.Majlind Lazimi ne Shkurt 2011.

Ju lutem referojuni notes 27.

Shoqëria e ka vendndodhjen në Shqipëri. Adresa e zyrës së saj të regjistruar është në: Tiranë, Rruga Abdyl Frasheri, EGT Tower, Pallati 12/1.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kryesore të kontabilitetit të aplikueshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përcaktuar më poshtë.

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të cilat janë lëshuar nga Bordi i Standardeve të Kontabilitetit ("BSNK").

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç rasteve kur SNRF kërkon baza të tjera matjeje, sic janë përmendur në politikat kontabel me poshte.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike të kontabilitetit. Kjo përgatitje kërkon gjithashtu që menaxhimi të ushtroje gjykim në procesin e aplikimit të politikave të kontabilitetit të shoqërisë. Fushat të cilat përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit ose kompleksitetit, apo fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë paraqitur në shënimin 4.

Të dhënat krahasuese janë riklasifikuar në bazë të prezantimit të këtij viti.

2.2 Ndryshimet në politikat kontabel

(a) Adoptimi i Standardeve të reja SNRF në vitin 2011

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje më ato të vitit të mëparshëm financiar përveç atyre në vijim. Shoqëria ka adoptuar politikat e reja dhe të ndryshuara në bazë të SNRF për BE dhe të interpretimeve KIRFN që nga 1 Janari i vitit 2011:

- SNK 24 Dhenia e Informacioneve Shpjeguese për Palet e Lidhura (amendime), në fuqi që prej 1 Janar 2011
- SNK 32 Instrumentat Financiare: Paraqitja (amendimet), në fuqi që nga 1 Shkurt 2010
- KIRFN 14 Parapagimet e Fondeve Minimale të Kerkuar (amenduar), në fuqi që nga 1 Janar 2011
- KIRFN 17 Shpërndarja e aktiveve jomonetare të pronarët, në fuqi që nga 1 Korrik 2010
- KIRFN 19 Shuarja e detyrimeve financiare me instrumenta kapitali, në fuqi që nga 1 Korrik 2010
- Përmirësimet në SNRF (Maj 2010)

Kur adoptimi i standardit ose i interpretimit konsiderohet se ka patur një impakt mbi pasqyrat financiare ose performancën e shoqërisë, efekti është përshkruar më poshtë:

SNK 24 Dhenia e Informacioneve Shpjeguese për Palet e Lidhura

Ndryshimet në SNK 24, Dhenia e Informacioneve Shpjeguese për Palet e Lidhura janë në fuqi për të gjitha vitet financiare duke filluar nga ose pas 1 Janar 2011 dhe duhet të aplikohen në mënyrë retrospektive. Standardi i rishikuar thjeshtezon kërkesat për dhenien e informacioneve shpjeguese për kompanitë që kontrollohen, kontrollohen në mënyrë të përbashkët ose influencohen në mënyrë të konsiderueshme nga qeveria si dhe qarteson konceptin e paleve të lidhura. Si rezultat, një kompani e tillë raportuese përjashtohet nga kërkesat e përgjithshme në lidhje me transaksionet dhe balancat me qeverinë dhe entitetet e lidhura me qeverinë. Për më tepër, standardi i rishikuar amendon edhe perkufizimin e një pale të lidhur ku interesat pjesëmarrës të një investitori konsiderohen të jenë pale të lidhur me investitorin dhe filialet e tij ndonëse dy njesitë në të cilat shoqëria ka interesa pjesëmarrës nuk janë pale të lidhura mes tyre. Ky standard nuk ka efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar dhe performancën e shoqërisë.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(a) Adoptimi i Standardeve të reja SNRF në vitin 2011 (vazhdim)

SNK 32 Instrumentat Financiare: Paraqitja (Klasifikimi i emetimit të drejtave)

Ne Tetor të 2009, BSNK emetoi një amendim për SNK 32, për klasifikimin e drejtave të emetimit. Amendimi hyn në fuqi për periudha që fillojnë me ose pas 1 Shkurt 2010. Për emetimin e drejtave të ofruara për një shumë fikse të monedhës së huaj, politika aktuale kërkon që këto tituj të njihen si detyrime derivativë. Amendimi pohon që nëse këto të drejta emetohen në mënyrë proporcionale të të gjithë aksionerët ekzistues të shoqërisë që i perkasin të njëjtes klase, për një sasi fikse monedhe, ato duhet të klasifikohen si tituj kapitali pavarësisht monedhës në të cilën është shprehur çmimi i ushtrimit. Ky amendim nuk ka efekt në pozicionin financiar apo performancën e shoqërisë pasi shoqëria nuk zoteron të tilla instrumenta financiare.

KIRFN 14 Kërkesat në lidhje me parapagimet për fondet minimale

Ky amendim heq konceptin e pasojave të pasyruara kur një entitet është subjekt i kërkesave të fondeve minimale dhe bën një pagesë me parë në kohë të kontributeve për të mbuluar këto kërkesa. Amendamenti lejon që një parapagim për kostot e shërbimeve të ardhshme nga shoqëria të mund të njihet si aktive pensioni. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave minimale të fondeve; për këtë shkak amendamenti i këtij interpretimi nuk ka efekt në pozicionin financiar apo performancën e Shoqërisë.

KIRFN 17 Shpërndarja e aktiveve jomonetare pronareve

Ky interpretim është në fuqi për periudha që fillojnë me ose pas 1 Korrik 2010. Interpretimi siguron një orientim për njohjen e shpërndarjes së aktiveve jomonetare të pronarët. Interpretimi qartëson momentin e njohjes së detyrimit, mënyrën e matjes dhe aktivitetin e lidhura, si dhe kur të mos njihet detyrimi dhe aktivi. Ky interpretim nuk ka impakt në pasqyrat financiare të konsoliduara, pasi Shoqëria nuk aplikon shpërndarje aktiveve jo monetare të pronarët.

KIRFN 19 Shuarja e detyrimeve financiare me instrumenta kapitali.

Ky interpretim hyn në fuqi për periudha që fillojnë me ose pas 1 Korrik 2010. Ky interpretim orienton kontabilizimin në momentin që termat e një detyrimi financiar rinegociohen dhe rezultojnë në një emetim titujsh kapitali për një kreditor të shoqërisë, për të shuar pjesërisht ose totalisht detyrimin financiar. Interpretimi nuk ka impakt në pasqyrat e konsoliduara, pasi Shoqëria nuk ka transaksione të tilla.

Përmirësimet në SNRF

Në Maj të vitit 2010, BSNK emetoi setin e trete të amendamenteve për standardet, fillimisht me qëllimin për të evituar mosperputhjet dhe qartësuar përmbajtjen. Ky set konsiston në dispozita të vecanta tranzitore për çdo standard. Adoptimi i amendamenteve të mëposhtme rezultoi në një ndryshim në politikat kontabël, por nuk ka impakt në pozicionin financiar apo performancën e Shoqërisë.

SNRF 7 Instrumentat Financiare – Shenimet Shpjeguese: Amendimet kanë për qëllim të thjeshtojnë shenimet shpjeguese duke reduktuar numrin e shënimeve shpjeguese lidhur me kolateralin e mbajtur dhe përmirësimin e shënimeve, duke kërkuar informacion çilesor për t'a asociuar me informacionin sasior perkates. Shoqëria i reflekton kërkesat e reja për shenimet shpjeguese.

SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare: Amendimi qartëson që një njesi mund të prezantojë një analizë për çdo komponent të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ndoshta edhe në pasqyrën e ndryshimeve në kapital ose në shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Të gjitha standardet dhe interpretimet e tjera, aplikimet e të cilave janë të detyrueshme për periudhën që fillon me ose pas 1 Janar 2011 nuk kanë efekt material në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

b) Standardet e reja të SNRF dhe interpretimet e KIRFN ende

Shoqëria po vlerëson së fundmi impaktet potenciale të standardeve të reja dhe të rishikuara si edhe interpretimeve që do të vihen në zbatim duke nisur nga 1 Janar 2012 ose më vonë. Standardet dhe interpretimet më domethënëse për aktivitetet e Shoqërisë janë detajuar si më poshtë:

SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare – Paraqitja e Zerave të Ardhrave Gjithëpërfshirëse
Amendimet e SNK 1 ndryshojnë grupimin e elementeve të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Elementet që mund të riklasifikohen në fitim/humbje në një periudhë të ardhme do të prezantohen të ndara nga elementet që nuk mund të riklasifikohen. Ky amendim ka efekt vetëm në prezantim dhe nuk ka impakt në pozicionin financiar ose performancën e Shoqërisë. Amendimi hyn në fuqi për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Korrik 2012.

SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat – Rimarrja për aktivet për të cilat është llogaritur tatimi
Amendimi sqaron përcaktimin e tatimit të shtyre për aktivet afatgjata të investimit që maten me vlerën e drejte. Ndryshimi prezanton një supozim të kundërshtueshëm që tatimi i shtyre për aktivet afatgjata të investimit i cili matet sipas modelit të vlerës së drejte në SNK 40 duhet të përcaktohet duke u bazuar në faktin se vlera kontabel neto e tij do të rikuperohet me anë të shitjes. Gjithashtu, ky ndryshim paraqet kërkesën që tatimi i shtyre për aktivet që nuk zhvlerësohen të cilat maten nepermjet përdorimit të modelit të rivlerësimit në SNK 16, të matet gjithmone në baza të shitjes së aktivitetit. Amendimi behet efektiv për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Janar 2012. Shoqëria nuk ka aktualisht investime në aktive afatgjata të investimit si dhe nuk aplikon modele të rivlerësimit, për këtë arsye amendimi nuk impaktin pozicionin financiar dhe performancën.

SNRF 7 Instrumentat Financiare: Informacionet shpjeguese (Trasferimi i Aktiveve Financiare)
Në Tetor 2010, BSNK emetoi një amendament për SNRF 7, i cili ndryshon kërkesat për dhenien e informacioneve shpjeguese për të ndihmuar përdoruesit e pasqyrave financiare për vlerësimin e ekpozimit ndaj riskut që lidhet me transferimin e aktiveve financiare dhe efektin e këtij risku në pozicionin financiar të shoqërisë. Shoqëria nuk pret që ky amendim të ketë impakt në pozicionin financiar ose performancën e Shoqërisë.

SNRF 7 Instrumentet Financiare: Informacionet shpjeguese (Kompensimi i aktiveve financiare me detyrimet financiare)
Në Dhjetor 2011, BSNK emetoi amendimin për SNRF 7, i cili kërkon nga njesitë të përfshijë në shënime shpjeguese informacion për të drejtën e kompensimit dhe marrëveshjet përkatëse për instrumentat financiare sipas një marrëveshjeje të zbatueshme kompensimi ose marrëveshjeje të ngjashme. Shoqëria është aktualisht duke vlerësuar impaktin e këtij amendimi në SNRF.

SNK 32 Instrumentet financiare: Paraqitja (Shuarja e aktiveve financiare me detyrimet financiare)
Në Dhjetor 2011, BSNK, ka emetuar amendimin e SNK 32, i cili ka për qëllim të qartësojë ceshtjet ekzistuese për zbatim lidhur me rregullat për shuarjen e detyrimeve financiare me aktivet financiare dhe të redukojë nivelin e lartë të diversitetit në praktiken ekzistuese. Aktualisht Shoqëria është duke vlerësuar impaktin e këtij amendimi.

SNRF 9 Instrumentat financiare – Klasifikimi dhe matja
SNRF 9 është emetuar në Nentor 2009 dhe është menduar të zëvendësojë SNK 39: Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja. Standardi prezanton kërkesa të reja për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe detyrimeve që duhet të aplikohen duke filluar nga 1 Janar 2005. Sipas SNRF 9 të gjitha aktivet financiare dhe detyrimet fillimisht njihen me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Standardi gjithashtu eliminon kategoritë e instrumentave financiare që aktualisht prezantohen në SNK 39: të disponueshme për t'u shitur

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

b) Standardet e reja të SNRF dhe interpretimet e KIRFN ende (vazhdim)

dhe të mbajtur deri në datën e maturimit. Në Tetor 2010 BSNK shtoi në SNRF 9 kërkesën për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare si dhe mos-njohjen e një aktivi financiar apo detyrimi financiar. Pjesa me e madhe e kërkesave në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare si dhe mosnjohjen e një aktivi financiar dhe detyrimeve financiare nuk kanë ndryshuar. Kërkesat në lidhje me vlerën e drejte për detyrimet financiare kanë ndryshuar për të paraqitur riskun specifik. Si rezultat, ndryshimet në riskun e kreditit nuk do të afektojnë fitimin/humbjen edhe nëse këto instrumenta janë mbajtur për shitje. Finalizimi i këtij projekti pritet të perfundojë në 2012. Adoptimi i SNRF 9 do të ketë efekt në klasifikimin dhe matjen e instrumentave financiare të Shoqërisë. Shoqëria do të paraqesë efektin se bashku me fazat e tjera, kur të emetohet standardi, për të paraqitur një pamje të plote.

SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara

SNRF 10 zëvendëson pjesërisht SNK 7 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale që orienton kontabilizimin lidhur me pasqyrat financiare të konsoliduara. Gjithashtu përfshin edhe ceshtjet e ngritura në KIS-12 Konsolidimi – Njesite me qëllime të vecanta. SNRF 10 përcakton një model të vetëm kontrolli që aplikohet në të gjitha kompanitë përfshirë edhe ato me qëllime të vecanta. Ndryshimet e paraqitura në SNRF 10 kërkojnë që menaxhimi të ushtrojë një gjykim të rëndësishëm për të përcaktuar cilat njesi kontrollohen dhe rrjedhimisht kerkohen të konsolidohen nga shoqëria “meme”, krahasuar me kërkesat që ishin në SNK 37. Ky standard hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 Janar 2013 dhe nuk ka efekt në pasqyrat individuale të Shoqërisë.

SNRF 11 Marreveshjet e Perbashketa

SNRF 11 zëvendëson SNK 31 Interesat në Sipermarret e Perbashketa dhe KIS-13 Njesi të kontrolluara bashkarisht – Kontribute Jomonetare nga Sipermarresit. SNRF 11 heq mundësinë e njohjes së njesive të kontrolluara bashkarisht duke përdorur konsolidim proporcional. Në vend të tij, njesite e kontrolluara bashkarisht të cilat plotësojnë perkufizimin e një Sipermarreje të Perbashkete duhet të njohën duke përdorur metodën e kapitalit neto. Ky Standard hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2013 dhe nuk kanë asnjë efekt mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNRF 12 Shenimet Shpjeguese të përfshirjes me entite të tjera.

SNRF 12 përfshin të gjitha shenimet shpjeguese që kanë qenë me përpara në SNK 27 lidhur me konsolidimin e pasqyrave financiare, si dhe të gjitha informacionet shpjeguese që kanë qenë me përpara të përfshira në SNK 31 dhe SNK 28. Këto informacione shpjeguese lidhen me interesat e subjektit në filialet, marreveshjet e përbashketa dhe njesite e strukturuar. Disa nga shenimet me kualitative dhe kuantitative të SNRF 12 përfshijnë: dhenia e informacionit të përmbledhur financiar për filialet me interesa jokontrrollues materiale; përshkrim të gjykimeve të rëndësishme të përdorura nga menaxhimi për të përcaktuar kontrollin, kontrollin e përbashkete dhe influencën domethënëse, si dhe llojin e marreveshjes së; përshkrimin e natyrës së riskut të lidhur me interesat e njesive e struktura të pakonsoliduara. Ky standard hyn në fuqi për periudha që fillojnë me ose pas 1 Janar 2013 dhe nuk ka efekt në pasqyrat individuale të Shoqërisë.

SNRF 13 Matja e vlerës së drejte

SNRF 13 përcakton një burim të vetëm udhëzues për të gjitha matjet me vlerën e drejte të parashikuara në SNRF. SNRF 13 nuk ndryshon kur një njesi kerkohet të përdoret vlerën e drejte, por siguron një udhëzues sesi matet vlera e drejte në SNRF kur vlera e drejte kerkohet apo lejohet. Shoqëria aktualisht po vlerëson impaktin që ky standard do të ketë në pozicionin financiar apo performancën. Standardi hyn në fuqi për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Janar 2013.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

b) Standardet e reja të SNRF dhe interpretimet e KIRFN ende (vazhdim)

SNK 19 Perfitimet e punonjesve (rishikuar)

Standardi i rishikuar përfshin një sërë amendimesh që fillojnë nga ndryshimet baze deri tek qartësimi i përmbajtjes (tekstit). Ndryshimi me domethenë përfshin ceshtjet e mëposhtme: për përcaktimin e planeve të perfitimit, aftësia për të shtyrë njohjen e humbjeve/fitimeve të aktuariale është hequr; ka kërkesa të reja ose të ndryshuara që përfshijnë informacion kuantitativ për ndjeshmerinë e planit të përcaktuar të perfitimeve ndaj një ndryshimi të mundshëm në secilin nga supozimet domethënëse aktuariale; perfitimet pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës do të njihen në momentin e parë kur këto perfitime nuk mund të terhiqen pas, ose në rastet kur kostot e ristrukturimit njihen sipas SNK 37; dallimi midis perfitimeve afatshkurtra dhe të tjera afatgjata për punonjësit do të bazohet në kohën e pritshme të mbylljes së detyrimit sesa në të drejtën e punonjësit për këto perfitime. Ky standard hyn në fuqi për periudha që fillojnë me ose pas 1 Janar 2013. Shoqëria aktualisht po vlerëson impaktin e standardit të rishikuar, por nuk pret ndonjë impakt domethënëse në pozicionin e saj financiar ose performancën.

SNK 28 Investime në Pjesëmarrje dhe Sipermarrjet e Perbashketa (rishikuar)

Si rezultat SNRF 11 dhe SNRF 12 të reja, SNK 28 është ndryshuar duke u quajtur SNK 28 Investime në Pjesëmarrje dhe Sipermarrjet të Perbashketa, dhe përkrahur aplikimin e metodës së kapitalit për investimet në sipermarrjet e përbashketa dhe pjesëmarrjet të tjera. Ky amendim hyn në fuqi për periudha që fillojnë me ose pas 1 Janar 2013 dhe nuk ka efekt në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë.

Permirosimet e SNRF

Në Maj 2010 BSNK ka emetuar rishikimet për SNRF 3. Ky përmirësim hyn në fuqi për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Korrik 2011.

SNRF 3 Kombinimi i Bizneseve: Opsionet për matjen e interesave jo-kontrollues janë amenduar. Vetëm komponentet e interesave jo-kontrollues që konsistojnë në një interes aktual pronësie dhe i japin të drejtën mbajtësit të tyre ndaj një pjese proporcionale në aktivet neto të shoqërisë në rast likuidimi duhet të maten me vlerën e drejtë ose me vlerën e aktualizuar të interesit të mbajtësit të tyre në aktivet neto të kompanisë. Të gjithë komponentet e tjera të interesave jo-kontrollues duhet të maten me vlerën e drejtë në momentin e blerjes.

2.3. Vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar kërkon nga menaxhimi vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve dhe dhenien e informacioneve shpjeguese për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në datën e raportimit të pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasoje e këtyre vlerësimeve. Shpjegimi i supozimeve kyçe është përfshirë në seksionet përkatëse të shënimeve, aty ku janë përkrahur vlerësimet domethënëse.

2.4 Këmbimi i valutës së huaj

(a) Monedha funksionale dhe ajo e raportimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në LEK e cili është dhe monedha funksionale e Shoqërisë. I gjithë Informacioni financiar i pasqyruar në LEK është i përafëruar në të njëjtën mënyrë (nëse nuk është shprehur ndryshe).

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.4 Këmbimi i valutës së huaj (vazhdim)

(b) Kursi i këmbimit valutor më 31 Dhjetor:

| | 2011 | 2010 |
|------------------|--------|--------|
| LEKE per 1 EUR | 138.93 | 138.77 |
| LEKE per 1 USD | 107.54 | 104.00 |
| LEKE per 1 CHF | 114.46 | 110.98 |
| LEKE per 100 YEN | 138.8 | 127.90 |
| LEKE per 100 KRW | 9.19 | 9.17 |
| LEKE per 1 XDR | 164.58 | 160.16 |

2.5 Aktivet Afatgjata Materiale

Toka dhe ndertesat përfshijne pergjithesisht nenstacione dhe ndertesat administrative per zyra. Te gjitha Aktivet Afatgjata Materiale (AAM) jane shfaqur me kosto historike (ashtu sic parashikohet ne paragrafin e meposhtem) minus zhvleresimet dhe reniet ne vlere, pervec tokes, e cila shfaqet me kosto minus renien ne vlere. Kosto përfshijne shpenzime qe lidhen direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve te ndertuara vete përfshin koston e materialeve dhe punen direkte, cdo kosto tjetër te lidhur direkt me transformimin e e aktivitetit ne kushte pune per qellimin e tij te caktuar si dhe koston e cmontimit dhe largimit te aktivitetit dhe kthimin e zones ku ka qene vendosur aktiviteti ne gjendjen e meparshme, deri ne masen e pranuar sipas dispozites së SNK 37. Cdo blerje programesh kompjuterike qe eshte pjese e pandashme e veprimtarise se pajisjes do te kapitalizohet si pjese e kesaj pajisjeje.

Ne 1 Janar 2007, AAM te Shoqerise u ndane nga aktivet e KESH sh.a. Keto AAM qe u ndane, u regjistruan me nje vlere te bazuar mbi vleren e mbartur te aktiveve ne pasqyrat financiare te KESH më 31 Dhjetor 2006. Shoqeria mëmë ka zgjedhur te vlerësojë nje pjese te konsiderueshme te AAM te veta pergjate kalimit të saj në SNRF më 1 Janar 2006 me vleren e drejte bazuar ne vleresimin e bere nga nje vleresues i pavarur qe prej 31 Dhjetor 2003, dhe ka perdorur keto shuma si baze per kosto te konsideruara per qellime raportimi ne baze te SNRF ne daten e rivleresimit.

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te AAM njihet ne vleren e mbetur te AAM vetem nese eshte e mundshme qe perfitime te ardhshme ekonomike te lidhura me kete pjese te zevendesuar do te rrjedhin ne Kompani si dhe nqs kostoja e saj mund te vlerësohet ne menyre te besueshme. Kostot ditore te mirembajtjes dhe te tjera te lidhura me AAM do te njihen ne shpenzimet e periudhes perkatese qe ato ndodhin.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.5 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

Kostoja e mirembajtjes, riparimit dhe zevendesimit të njesive jo të rëndësishme të AAM regjistrohet si shpenzim mirembajtjeje në periudhën kur ndodh. Rinovimet dhe permiresimet kapitalizohen. Kur kryhet shitja, nxjerrja jashtë përdorimit ose zevendesimi i një pjese të AAM, kostoja dhe zhvleresimi i akumuluar perkates i zerit të nxjerre jashtë përdorimit ose pjesës së zevendesuar eliminohen nga llogaritë. Fitimi ose humbja që mund të rezultojë regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave.

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka ndonjë indikacion që ndonjë aktiv mund të ketë pësuar rënie në vlerë (të jetë zhvlerësuar). Kur një indikator i tillë ekziston, Shoqëria rishikon shumën e rikuperueshme të aktiveve të saj afatgjata materiale për të përcaktuar nëse këto shuma vazhdojnë të tejkalojnë vlerat e mbartura të aktiveve. Zhvleresimi i identifikuar i aktiveve afatgjata materiale njihet direkt në pasqyrën e të ardhurave në zerin e shpenzimeve të tjera operative.

Zhvleresimi

Shoqëria zhvlerëson koston fillestare të AAM minus vlerën e rikuperueshme duke përdorur metoden lineare të zhvleresimit përgjatë jetës ekonomike të vlerësuar. Çdo pjesë e njësisë së AAM me një kosto që është domethënëse në lidhje me koston totale të njësisë zhvlerësohet veçmas. Tabela e mëposhtme shfaq kohën e përdorimit të vlerësuar të aktiveve:

| | <u>Jetëgjatësia (në vite)</u> |
|------------------------|-------------------------------|
| Ndertesa dhe struktura | 20 – 50 |
| Makineri dhe pajisje | 4 – 25 |
| Mjete transporti | 4 – 20 |
| Pajisje zyre | 8 – 15 |

Vlera e mbetur e aktiveve, jetëgjatësia dhe metodat e zhvlerësimit janë rishikuar, rregulluar aty ku është e nevojshme, në fund të çdo viti financiar.

2.6 Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlerat e mbartura të aktiveve jo-financiare të Kompanisë, përveç inventareve dhe aktivitetit të shtyre tatimor, do të rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikacion për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë indikacion i tillë, vlera e përfutëshme e aktivitetit duhet të vlerësohet. Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit njihet, kur vlera e mbartur është më e lartë se vlera e tij e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë e aktiveve njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e lartë e vlerës në përdorim të tij ose vlerës së drejtë të aktivitetit minus kostot e shitjes. Kur bëhet vlerësimi i vlerës në përdorim të aktivitetit, flukset e ardhshme të vlerësuarat monetare skontojnë në vlerën e tyre të tanishme, duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin e tanishëm të tregut të vlerës së parase dhe të riskut specifik të aktivitetit.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për çdo indikacion të mundshëm nëse humbja është rritur apo nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë rikthehet nëse ka ndryshime në vlerësimet e bera për përcaktimin e vlerës së përfutëshme. Një humbje nga rënia në vlerë kthehet deri në vlerën që vlera e mbartur e aktivitetit nuk kalon vlerën e mbetur që do përcaktohej, neto nga zhvlerësimet dhe amortizimet, nëse humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit nuk do të njihet.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.7 Rënia në vlerë e aktiveve financiare

Nje aktiv financiar do te konsiderohet i zhvleresuar ne rastin kur ekzistojne fakte te dukshme qe nje ose disa ngjarje kane patur efekt negativ ne fluksin e vleresuara te prishme monetare.

Nje humbje nga zhvleresimi i aktiveve financiare i matur me koston e amortizimit perlllogaritet si diference midis vleres ekzistuese dhe vleres aktuale te fluksit te ardhshem te parave te aktualizuar me normen fillestare efektive te interesit.

Aktivitetet financiare te rëndësishme testohen per zhvleresim ne baze individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vleresohet ne grup, per grupe qe ndajne karakteristika te ngjashme risku.

Nje zhvleresim i aktivitetit mund te jete i kthyeshem ne rast se ky kthim mund te lidhet me nje ngjarje objektive e cila ndodh pas njohjes se zhvleresimit te aktivitetit. Per aktivitetet financiare te matura me koston e amortizuar, kthimi njohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve

2.8 Inventaret

Inventaret vlerësohen me vleren me te vogel mes koston dhe vleres neto te realizueshme. Kosto e inventarit bazohet ne parimin "Hyrje e pare – dalje e pare" ("FIFO": first in-first out) dhe perfshin shpenzimet e njohura gjate blerjes se inventarit, prodhimit ose koston se tjetersimit dhe kostove te tjera shtese te njohura per ruajtjen dhe sjelljen ne pozicionin ekzistues te inventarit. Ne rastin e inventarit te prodhuar dhe prodhimit ne process koston perfshijne nje marzh te kostove shtese prodhuese bazuar ne operimin me kapacitet normal.

Vlera neto e realizueshme eshte ekuivalente me diferencen e cmimit te shitjes se parashikuar ne rastin e nje veprimtarie normale te biznesit me koston totale te parashikuara dhe shpenzimet e shitjes.

2.9. Instrumentat financiare

Shoqeria zoteron vetem instrumenta financiare jo – derivative duke perfshire llogarite e arketueshme nga shitjet dhe llogari te tjera te arketueshme, para dhe ekuivalentet e saj, kredi dhe hua, si edhe llogari te pagueshme e detyrime te tjera.

Instrumentat financiare jo-derivative vleresohen fillimisht me vleren e tyre te drejte plus, per instrumente jo te matur me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes, koston e tjera te transaksionit. Pas njohjes fillestare keto instrumenta jo- derivative maten si me poshte:

Nje instrument financiar njihet ne momentin kur shoqeria behet pjese e dispozitive kontraktuale te instrumentit. Aktivitetet financiare nuk njihen nqs te drejtat kontraktuale te kompanise mbarojne ose nderpriten ose nese kompania transferon aktivin financiar nje pale tjetër pa pastur kontroll ose te gjitha risqet dhe shperblimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet e zakonshme te aktiveve financiare njihen në daten e tregtimit, dmth daten qe kompania merr persiper te bleje apo të shesë aktivin.

Detyrimet financiare nuk njihen nese detyrimet e shoqerise të specifikuar në kontratë mbarojnë ose anulohen.

Aktivitetet monetare dhe ekuivalente te tjere

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë para në dorë, depozitat e lira ne banka dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitet fillestar prej tre muajsh ose më pak.

Llogarite e arketueshme

Te drejtat ndaj te treteve njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas vleresohen me diferencen e koston se amortizuar me humbjet nga zhvleresimi.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.9 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme fillimisht regjistrohen me vlerën e tyre të drejte dhe më pas me koston e tyre të amortizuar.

Kredite dhe Huamarrjet

Pas njohjes fillestare, kredite dhe huatë njihen me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë midis kostos dhe vlerës së shlyerjes duke u njohur në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

Të tjera

Instrumentet e tjera financiare jo-derivative maten si diferencë e koston së amortizuar, duke përdorur metodën efektive të interesit, me humbjet nga renia në vlerë (zhvlerësimi).

Trajtimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare jepet me qartë në shenimin 2.10

Vlera e drejtë e të drejtave ndaj të treguarve, duke përfshirë punën e prodhimit në proces, është vlerësuar si vlerë aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë aktualizuar me normën e interesit të tregut në datën e raportimit.

Instrumentet financiare janë të klasifikuara si detyrime aktuale vetëm nëse kompania ka të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë zgjidhjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

2.10. Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi mbi gjendjen e fondeve në banke dhe fitimet nga kursi i kembimit i njohur në Pasqyrën e të Ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen në vazhdimësi, duke përdorur metodën efektive të interesit.

Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimi i interesit të huave si dhe humbjet nga kursi i kembimit.

2.11. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë i të ardhurave

Shpenzimet tatimore përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyrë. Shpenzimet tatimore njihen në Pasqyrën e të Ardhurave, përveçse kur lidhen me zera të njohur drejtpërdrejt në kapital dhe në një rast të tillë ato njihen si pjesë kapitale.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose të miratuara në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur melodeon e bilancit, duke marrë parasysh diferencën të përkohshme ndërmjet vlerës neto kontabël në bilanc të një aktivi ose pasivi për qëllime të raportimit financiar dhe bazës së tij tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen në diferencat e përkohshme, kur ato të kthehen mbrapsht, në bazë të ligjeve që janë nxjerrë ose miratuar në datën e raportimit.

Një aktiv i shtyrë tatimor është i njohur në atë masë në të cilën fitimet e tatueshme të ardhshme do të jenë në dispozicion në varesi të diferencës së përkohshme që do të mund të përdoret. Aktivet e shtyra tatimore shqyrtohen në çdo datë të raportimit dhe zbriten në masën që nuk është më e mundshme që të kete përfitime tatimore.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.12. Përfitimet e punonjësve

(a) Fondet për pension, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Kompania është e detyruar nga legjislacioni aktual shqiptar për të derdhur kontribute fikse në emër të të punësuarve në një fond për sigurim shoqëror të përcaktuar nga Qeveria. Të gjitha këto pagesa / detyrime njihen si shpenzime në periudhën me të cilën ato lidhen.

(b) Përfitimet pas ndërprerjes së punës

Në përputhje me Kontratat e punës kolektive, në rast të përfundimit të një kontrate pune pasi punonjësi ka arritur moshën e nevojshme në bazë të ligjit për dalje në pension, pavarësisht nga arsyeja për ndërprerjen e punës, punonjësi ka të drejtë për një kompensim prej dy paga mujore bruto.

Përfitimet e ndërprerjes së punës njihen si shpenzime kur kompania i është nënshtruar, pa mundësi reale për t'u tërhequr, një plani të detajuar zyrtar për ndërprerjen e punësimit para datës së daljes në pension ose për të siguruar përfitime për ndërprerje të mardhenies së punës si rezultat i një oferte që mund të bëhet punonjesit për largim vullnetar. Përfitimet pas ndërprerjes së punës për largime vullnetare njihen si një shpenzim në qoftë se kompania ben një ofertë inkurajuese për largim vullnetar, është e mundur që kjo ofertë të pranohet dhe numri i pranimeve mund të vlerësohet lehtësisht

2.13. Provizionimi

Provizionimi njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të kaluar, kompania ka një detyrim ligjor aktual ose të ardhshëm që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që një pjesë e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të ardhshme të parave me normën e para – tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parase dhe risqet specifike që lidhen me atë detyrim.

2.14. Njohja e të ardhurave

Te ardhurat janë fluksi bruto i përfitimeve ekonomike gjatë periudhës aktuale dhe normale të aktivitetit të një njesie ekonomike, kur ato flukse rezultojnë në rritje në kapital, përveç rritjeve të kontributeve nga pjesëmarrësit e kapitalit. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të konsideruar dhe pranuar si të arkëtueshme për shitjen e mallrave dhe shërbimeve gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë së kompanisë. Te ardhurat janë të njohura neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kthimet, rimbursimet dhe zbritjet.

Shoqëria i njeh të ardhurat në bazë të faturave të lëshuara për energjinë e furnizuar, kur shumat e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që njesia do të marrë përfitimet e ardhshme ekonomike. Shumat e të ardhurave nuk mund të konsiderohen të matshme me besueshmëri derisa të gjithë detyrimet e kushtezuara që kanë të bëjnë me shitjen të jenë zgjidhur. Kompania bazon vlerësimet e saj mbi rezultatet historike, duke marrë parasysh llojin e konsumatorit, llojin e transaksionit dhe specifikat e çdo marrëveshjeje.

(a) Shitjet e energjisë elektrike

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike përbëjnë vlerën e faturuar të energjisë elektrike të furnizuar. Faturimet e energjisë elektrike bëhen në baza mujore.

(b) Të ardhura të tjera

Të ardhurat mbi shërbimet e ofruara klienteve si psh. ndryshimi i emrit në kontrate, verifikimi i matesit, janë të njohura kur shërbimi ofrohet. Këto të ardhura, sëbashku me të ardhurat nga kamatvonesat për pagesat me vonesë janë të përfshira në të ardhura të tjera.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.15. Qiratë

Kontratat e qirave në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe perfitimeve nga pronësia janë të mbajtura nga qiradhënësi janë klasifikuar si qira operative. Pagesat e bëra nën zerin e qirave operative (neto duke i zbritur të gjithë stimujt e marre nga qeramarresi), futen në pasqyrën e të ardhurave me baze lineare gjatë gjithë periudhës së qerasë.

2.16. Grantet qeveritare dhe grante të tjera

Grantet qeveritare janë njohur fillimisht si të ardhura të shtyra, kur ekziston siguria e arsyeshme se ato do të përfitohen dhe se kompania do të përmbushë kushtet e lidhura me grantin. Grantet që kompensojnë kompaninë për shpenzimet e bëra janë të njohur në Pasqyrën e të Ardhurave në mënyrë sistematike në të njëjtën periudhë në të cilën shpenzimet janë njohur. Grantet që kompensojnë kompaninë për koston e një aktiviteti janë të njohur në Pasqyrën e të Ardhurave në bazë sistematike gjatë jetës së përdorimit të aktivitetit.

3. Menaxhimi i riskut financiar

Funksioni i Menaxhimit të riskut në kompani është kryer në lidhje me rreziqet financiare (rreziku i kredise, i tregut, i kursit të këmbimit, i likuiditetit dhe i normave të interesit), rreziqet operacionale (të tilla si rrezik për mjedisin) dhe rreziqe ligjore. Objektivat kryesore të funksionit të menaxhimit financiar të rrezikut janë për të vendosur kufijtë e rrezikut dhe pastaj të sigurojë se ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojnë brenda këtyre kufijve. Menaxhimi operacional dhe ligjor ka për qëllim të sigurojë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurat e brendshme për të minimizuar risket operacionale dhe ligjore.

3.1 Risku i kredise

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që një pale në instrumentin financiar do të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër, duke mos arritur që të shlyhet detyrimi. Ekspozimi kryesor i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë lind për shkak të drejtave ndaj te treteve.

Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj riskut të kredisë korrespondon me shumat e mbartura të aktiveve financiare në bilanc.

Impakti i kompensimit të mundshëm të aktiveve dhe detyrimeve për të reduktuar ekspozimin ndaj riskut të kreditit nuk është domethënës.

3.1.1 Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Kompania është e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit në veprimtarinë e saj të përditshme, sepse është e mundur që klientët e saj si dhe huamarrësit do të dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre financiare. Strukturat e Kompanisë, nivelet e rrezikut të kredisë që merr përsipër duke e vendosur kufizime në sasinë e rrezikut të pranuar në lidhje me pale të treta dhe nëpërmjet diversifikimit të portofolit të kredisë janë metoda në menaxhimin e riskut. Kufijtë persa i perket nivelit të rrezikut të kredisë janë miratuar rregullisht nga menaxhmenti. Rreziqet e tilla janë të monitoruara në një bazë të ndryshueshme dhe i nënshtrohet një analizë vjetore ose më të shpeshta.

3.1.2 Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj përqendrimeve të rrezikut të kredisë. Menaxhimi monitoron përqendrimin e rrezikut të kredive, por has vështirësi në zbatimin e politikave me të mira të menaxhimit të ekspozimit të kompanisë ndaj rrezikut të tillë duke diversifikuar portofolin e kredisë. Kjo ndodh për shkak se shoqëria është e detyruar të furnizojë me energji konsumatorin final. Në kushte të tilla, diversifikimi është i vështirë për t'u

3. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredise (vazhdim)

3.1.2 Perqendrimi i rrezikut të kredise (vazhdim)

aplikuar. Në rastin e shitjes së energjisë, rreziqet e kompanisë ekzistojnë në mospërmbushjen e objektivave të saj, për një ose më shumë nga arsyet e mëposhtme: a) konsumatorët refuzojnë të paguajnë faturat e tyre, b) konsumatorët nderhyjnë apo shkëpusin matesat, c) gjykatat nuk janë në gjendje apo të gatshëm për të mbështetur shkeljet apo veprime të tjera ndaj konsumatorëve që nuk paguajnë.

Depozitat bankare të kompanisë mbahen në gjashtëmbëdhjetë banka të ndryshme.

3.2 Risku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes që rezulton nga ndryshimet në çmimet e tregut vendas (tarifave të transmissioinit të energjisë), normat e këmbimit valutor si dhe normat e interesit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit kompania është e ekspozuar në një moment në kohë ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritjet e çmimeve në të ardhmen apo lëvizjet e kursit të tregut dhe përbërjen e aktiveve të kompanisë dhe të portofolit të kontratës.

Menaxhimi i përcakton kufijtë për vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili është vëzhguar në baza mujore. Megjithatë, përdorimi i kësaj metode nuk ka parandaluar humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të ndjeshme të tregut.

3.2.1. Risku nga këmbimi valuator

Risku nga kursi i këmbimit vjen nga fakti se të ardhurat e shoqërisë dhe pjesa më e madhe e kredive të saj dhe të drejtat ndaj të treta janë në lekë, ndërsa një pjesë të konsiderueshme të huave të kompanisë janë në valutë të huaj (kryesisht Euro dhe Dollarë amerikanë). Risku shkaktohet nga fakti se vlera e monedhës funksionale do të ndryshojë duke qenë se flukset e parave që dalin nga shlyerja e huave dhe interesave të lidhura me to do të ndryshojnë si rezultat i lëvizjeve në kursin e këmbimit, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në fitimin e kompanisë.

Ekspozimi total është i barabartë me ekspozimin neto për zërat e bilancit në valuta të tjera nga Leku. Ekspozimi total neto i shprehur në Lekë më 31 Dhjetor 2011 dhe 31 Dhjetor 2010, është respektivisht 26,740,627 mijë lekë dhe 22,994,484 mijë lekë.

3.2.2 Risku nga norma e interesit

Në rrjedhën normale të biznesit Shoqëria merr hua për të financuar operacionet e saj. Kompania është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës të interesit për shkak se vlera e drejtë e huase me normë fikse dhe flukset e lidhura me hua me norme të ndryshueshme do të sjellin ndryshime në normat e interesit.

Shoqëria nuk ka politika formale dhe procedura në fuqi për menaxhimin e rreziqeve të normës së interesit për aq kohë sa menaxhimi e konsideron këtë rrezik si të parëndësishëm duke qenë se Shoqëria aktualisht zotëron hua pa interes ose me norma interesi në ato të tregut.

3.2.3 Risqe të tjera të çmimeve

3.2.3.1 Çmimet e kapitalit

Shoqëria nuk ka ekspozim ndaj riskut të çmimit të kapitalit, për aq kohë sa ajo nuk zotëron aktive financiare të përbërë nga instrumente të kapitalit. Nuk është në politikën e kompanisë blerja e instrumenteve të tilla dhe duke qenë kështu ajo nuk është e ekspozuar nga lëvizjet e çmimeve në tregun e kapitalit.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.2.3.2 Çmimet e energjisë

Sipas modelit të tregut aktual të energjisë, kompania perlllogarit nje tarife fikse për njësi të energjisë siç është miratuar nga Enti Shqiptar Rregullator i Energjisë. Sipas kuadrit legjislativ, parashikohet që kompania të perballoje shpenzimet që vijnë në formën e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, si dhe blerjen dhe shitjen e energjisë se balancuar, e cila është sasia e energjisë e nevojshme për të mbushur hendekun midis konsumit dhe furnizimit të energjisë në një periudhë të caktuar të ditës. Çmimi i energjisë elektrike në tregjet vendase dhe ndërkombëtare është veçanërisht i rëndësishëm për kompaninë në rrethana të tilla të reja.

Çmimet e energjisë që Shoqëria do të mund të aplikojë në lidhje me energjinë e blerë dhe të shitur duke filluar nga 2008, do të jetë subjekt i miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri, gjë që do të sjellë një risk të çmimeve.

3.3. Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është përcaktuar si risku që një njesi ekonomike do të hase vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet financiare. Kompania është e ekspozuar ndaj kërkesave të përditshme për likuiditet, kryesisht në mënyrë që të mbulojë shpenzimet e saj operative gjate veprimtarise normale si dhe për të shlyer borxhet e saj. Nga ana tjetër, kompania përballet me vonesa të konsiderueshme në grumbullimin e të ardhurave për energjinë e sidomos nga konsumatorët individuale. Menaxhimi monitoron me kujdes parashikimet për arketimet/pagesat mujore (levizjet e flukseve te parave).

Procesi i menaxhimit të likuiditetit të miratuar nga ana e menaxhimit përfshin edhe vendosjen e afateve për shpenzimet e zonave që lidhen me aktivitetet e përditshme si për shërbimet, furnizimet, investimet, shtyrjen e pagesave të kreditorëve të caktuar, apo shtyrjen e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet palëve, duke parashikuar pagesat e borxhit dhe siguruar se ato janë të mbuluara, etj.

Shumat ne tabelën e maturiteteve janë flukset e parave rezervë, duke përfshirë edhe pagesat e borxhit. Këto flukse parash mund të ndryshojnë nga shuma e përfshirë në pasqyrën e bilancit të konsoliduar për shkak se gjendja ne bilanc është bazuar në shumën e aktualizuar te flukseve te parasë.

Kur shuma për t'u paguar nuk është fikse, shuma e treguar është vendosur duke iu referuar kushteve ekzistuese në datën e raportimit. Pagesat në monedhë të huaj janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datën e bilancit, të shpallur nga Banka Kombëtare e Shqipërisë.

Maturiteti kontraktual i detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2011 (në mijë lekë) shprehet si më poshtë:

| | Kredi | Hua afatshkurtër | Detyrime për t'u pagur dhe detyrime të tjera |
|-------------------------|-------------------|-----------------------------|---|
| Më pak se 1 vit | 1,480,953 | 5,345,357 | 14,711,108 |
| Ndërmjet 1 dhe 5 viteve | 8,013,480 | - | - |
| Më vonë | 9,718,921 | - | - |
| Totali | 19,213,355 | 5,345,357 | 14,711,108 |

3.4. Vlerat e drejta

Vlera e drejte është shuma me të cilën një instrument financiar mund të shkëmbehet në një transaksion në mes dy paleve te gatshme, përveç se ne rastin e një shitjeje të detyruar ose të likuidimit të menjëhershëm, dhe është përcaktuar më së miri nga një çmim tregu.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011***(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)***3. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****3.4 Vlerat e drejta (vazhdim)****Vlerat e drejta të instrumenteve financiare**

Vlera e drejte përcaktohet si shuma me te cilen instrumenti mund të shkëmbehet në një transaksion aktual ndërmjet palëve të gatshme në një transaksion ku palët veprojnë në mënyrë të pavarur (parimi arm's length), përveçse në rastin e një shitjeje të detyruar ose të likuidimit të menjëhershëm.

Vlerat e drejta merren nga cmimet e kuotuar në treg, modelet e skontimit të fluksit të parase dhe modelet e cmimive të tregut për produktet, sipas rastit.

Metodat dhe supozimet e mëposhtme përdoren për të vlerësuar çmimin e tregut në cdo kategori të instrumenteve financiare:

Aktive monetare dhe ekuivalente të tjere, investimet afatshkurtra

Vlera e mbartur e parave dhe aktiveve financiare afatshkurtra përafërsisht me vlerën e drejte në bazë të maturimit relativisht afatshkurtër të këtyre instrumenteve financiare.

Llogari të arkëtueshme dhe për t'u paguar

Vlera e mbartur e llogarive të arkëtueshme dhe për t'u paguar përafërsisht me vlerën e drejte në bazë të maturimit relativisht afatshkurtër të këtyre instrumenteve financiare.

Kredi afatshkurtra

Vlera e mbartur përafërsisht me vlerën e drejte për shkak të periudhës së shkurtër të maturitetit të këtyre instrumenteve.

Borxhi afatgjatë

Vlera e drejte e borxhit afatgjatë bazohet në flukset kontraktuale të skontuara me normat e përshtatshme të tregut. Sasia e mbartur e borxhit afatgjatë dhe llogarive të tjera për t'u paguar me norma të ndryshme interesi përafërsisht me vlerën e tyre të drejte.

Vlerat e mbartura dhe vlerat e pritshme të drejta të instrumentave financiarë më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 janë si më poshtë (në mijë lekë):

| | Kategoria | 2011 | | 2010 | |
|---|-----------|-------------------|----------------|-------------------|----------------|
| | | Vlerat e mbartura | Vlera e drejte | Vlerat e mbartura | Vlera e drejte |
| Aktivet: | | | | | |
| Aktive afatshkurtra | | | | | |
| Llogari te arketueshme | KLLA | 17,182,656 | 17,182,656 | 8,543,378 | 8,543,378 |
| Aktivet monetare dhe ekuivalente te tjere | KLLA | 345,523 | 345,523 | 510,241 | 510,241 |
| Aktive te tjera afatshkurtra | KLLA | 1,396,586 | 1,396,586 | 339,341 | 339,341 |
| Detyrimi: | | | | | |
| Borxhi afatgjate | KA | (18,308,929) | (11,791,100) | (14,094,122) | (9,591,228) |
| Borxhi afatshkurter | KA | (5,160,237) | (5,160,237) | (8,436,102) | (8,436,102) |
| Llogarite e pagueshme | KA | (14,711,408) | (14,711,408) | (9,808,719) | (9,808,719) |
| Te tjera te pagueshme | KA | (5,187,052) | (5,187,052) | (2,788,078) | (2,788,078) |

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.4 Vlerat e drejta (vazhdim)

| | |
|------|--|
| KLLA | Kreditë dhe Llogaritë e Arkëtueshme |
| KA | Detyrimet financiare me koston e amortizimit |

3.4.1. Aktivet financiare te regjistruara me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e kredive dhe arkëtimit mendohet t'i perafrohet vleres aktuale sikur të ishin afatshkurtra dhe pa interes.

3.5. Menaxhimi i Kapitalit

Kur flitet për menaxhimin e kapitalit objektivat e kompanisë janë të tilla për të ruajtur një vazhdueshmëri normale të aktivitetit në mënyrë që të sigurohen fitime për aksionerët dhe përfitime për palët e interesuara si edhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit në mënyrë që të reduktohet sa më shumë kosto e kapitalit. Për të ruajtur ose përshtatur strukturën e kapitalit, Kompania mund të rregullojë shumën e dividendëve të paguar për aksionarët, kapitalin e kthimit të aksionarëve, të emetojë aksione të reja ose të shesë pasuri për të reduktuar borxhin.

4. Vlerësimet kritike dhe gjykime të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet bëhen në vazhdimësi dhe bazohen në përvoja historike, duke përfshirë kohën e para ndarjes si dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë ngjarje të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Kompania bën vlerësimet dhe supozimet lidhur me të ardhmen. Vlerësimet e kontabilitetit do të rezultojnë, sipas rasti, pothuajse të barabarta me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një rrezik të konsiderueshëm dhe mund të shkaktojnë një rregullim material në vlerat e aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë diskutuar më poshtë:

4.1. Vlerësime dhe supozime kritike kontabël

(a) Vlera e drejte e instrumentave financiare

Vlera e drejte e instrumentave financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (për shembull, hua të marra ose të dhena punonjësve) përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të zgjedhur një numër metodash dhe ben supozime që bazohen kryesisht në kushtet e tregut në cdo datë bilanci. Shoqëria përdor metodën e skontimit të fluksit të mjeteve monetare për aktive dhe detyrime financiare që nuk tregtohen në tregje aktive

(b) Aktivet materiale afatgjata

Drejtimi i shoqërisë përcaktojnë jetën e dobishme të pritur të përdorimit dhe normat e zhvlerësimit, në lidhje me aktivet afatgjata që ka në zotërim (Shënimi 5). Ky vlerësim bazohet në ciklet e përcaktuara të jetës së aktivitetit. Kjo mund të ndryshojë në varesi të ndryshimeve të mundshme në treg. Ndryshimet e mundshme jetëgjatësinë e përdorimit të aktivitetit mund të çojnë në axhustime të vlerës së tyre neto.

(c) Rënie në vlerë e aktiveve financiare (hua dhe llogari të arkëtueshme)

Shoqëria ndjek udhëzimet e SNK 39 për të përcaktuar se kur një aktiv financiar ka pësuar rënie në vlerë. Ky përcaktim kërkon gjykim të thellë. Gjate kryerjes së këtyre gjykimeve, Shoqëria vlerëson, vec faktoreve të tjera, kohezgjatjen dhe shtrirjen gjate të cilës vlera e drejte e një investimi është më e vogël se kostoja e tij dhe flukset e veta të mjeteve monetare.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Vlerësimet kritike dhe gjykime të kontabilitetit (vazhdim)

4.1 Vlerësime dhe supozime kritike kontabël (vazhdim)

Vlera e renies në vlerë si dhe llogaritë e arketueshme perkatëse shfaqen në Shenimin nr. 9. Rigjykimi i renies në vlerë të llogarive të arketueshme në vitin pasardhës mund të çojnë në korrigjime të vlerës së mbartur të llogarise së arketueshme.

4.2. Gjykimet në lidhje me Parimin e vijimesise

Supozimi për pasqyrat financiare – Parimi i vijimesise

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimini se Shoqëria do të ketë vijimesi të aktivitetit të saj pa konkluduar në një përfundim specifik në lidhje me këtë fakt.

Pershkrimi i pasigurive (Pershkrimi i zhvillimeve të vitit 2012)

Shoqëria ka shfaqur humbje domethënëse gjatë vitit 2012 dhe ka patur gjithashtu një mundësi të kapitalit punues. Gjithashtu përgjatë vitit 2012, Shoqëria është përballur me flukse monetare negative nga aktivitetet operative si rezultat i disa masave rregullatore dhe të tjera demtuese ndërmarrë ndaj Shoqërisë nga autoritetet dhe njesitë respektive të shtetit Shqiptar përpara dhe gjatë vitit 2012, siç përshkruhet shkurtimisht më poshtë. Është e pasigurte nëse dhe kur Shoqëria do të ketë përfitueshmeri dhe flukse monetare rrjedhese pozitive.

Në 31 Dhjetor 2011 Shoqëria ka një mundësi të kapitalit qarkullues në shumën LEK 11,798 milion duke përfshirë overdarftë bankare në shumën LEK 5,160 milion dhe humbje neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011 në shumën LEK 4,487 milion. Flukset monetare nga aktivitetet operative janë rritur në shumën LEK 1,183 milion. Shoqëria është përballur me një sërë pasigurish në lidhje me kushtet e tregut, mjedisi rregullator, ligjor dhe fiskal, si edhe situatën aktuale politike.

Sikurse u përmend edhe më sipër, situata financiare e Shoqërisë është përkeqësuar në mënyrë domethënëse nga fillimi i vitit 2012 si rezultat i veprimeve të shumta rregullatore të ndërmarrë nga Enti Rregullator i Shpërndarjes dhe autoritetet e tjera shqiptare ndaj Shoqërisë. Këto veprime demtuese kanë përkeqësuar në mënyrë domethënëse aktivitetet e Shoqërisë në Shqipëri dhe përfshijnë pa kufizime, çeshtjet e mëposhtme:

Pas mos-miratimeve të studimeve të eksperteve nga ana e ERE (pasi ERE-s i ishte kërkuar të ndermernte të tilla veprime në zbatim të marreveshjes së privatizimit) dhe veprimeve të tjera përkeqësuese të ndërmarrë nga autoritet shqiptare ndaj Shoqërisë gjatë vitit 2009 dhe vitit 2010, respektivisht, ERE në 30 Shtator 2011 refuzoi aprovimin e Studimit mbi Borxhin e Keq të përgatitur nga eksperte të pavarur (Deloitte) që përcaktonin parametrat thelbësorë (Zbritjet për borxhin e Keq) për llogaritjen e tarifave për furnizimin publik me pakicë (FPP.)

Në këtë mënyrë, në 1 Janar 2012, ERE në formë arbitrare vendosi për Shoqërinë tarifën e reja për Shërbimin e Shpërndarjes ("DSO") dhe të Furnizimit Publik me Pakicë ("FPP") për periudhën 2012 – 2014, të cilat përveç të tjerave, nuk përkojnë me kushtet e vendosura në marreveshjen e privatizimit në vitin 2009. Për më tepër, në 1 Janar 2012, ERE rriti cmimin me të cilin KESH i faturon energjinë kompanisë CEZ me 91%. Në vazhdimësi, kompania i ankimoi tarifën e reja DSO dhe FPP, ndër të tjera, përpara gjykatës së rrethit Tiranë, por deri në këtë moment asnjë vendim lidhur me këtë ngjarje nuk është zbardhur. Për këtë arsye, deri në këtë moment tarifën DSO dhe FPP mbeten të pandryshuara.

4. Vlerësimet kritike dhe gjykime të kontabilitetit (vazhdim)

4.2 Gjykimet ne lidhje me Parimin e vijimesise (vazhdim)

Ne vazhdimesi te negociatave intensive nga ana e perfaqesuesve te Shoqerise dhe institucioneve shqiptare lidhur me situaten e veshtire financiare te Shoqerise, ERE vendosi te reduktoje cmimin e energjise se prokuruar nga KESH nga 2,830 ne 2,200 LEK/MWh, gje e cila reduktoi rritjen vjetore te cmimit nga 91% ne 49%. Me pas, si rezultat i reklamimit te suksesshem te Shoqerise ne gjykate ndaj ERE, ERE aprovoi pjeserisht studimin mbi Borxhin e Keq.

Ne 3 Gusht 2012, detyrime shtese tatimore dhe penalitete ne shumen rreth 4 miliard LEK u vendosen per Shoqerine nga autoritetet tatimore. Bazuar ne kete vendim, Shoqeria ka paguar brenda nje muaji shumen e 2.1 miliard LEK, sic kerkohet nga autoritete fiskale, ne menyre qe te permbushe kerkesat ligjore per apelimin, me qellim rishikimin e vendimit. Si baze per shtesen e detyrimeve tatimore, inspektorët tatimore kane paraqitur diferencat qe rezultojne nga energjia e blere nga KESH si furnizuesi publik me shumice me energjiine e ofruar nga Shoqeria per konsumatorët ne funksionin e saj si furnizues publik me pakice si energji e shitur per qellime fiskale dhe jo si humbje e njohur ne rrjetin e shperndarjes. Bazuar ne kete supozim jo korrekt, TVSH e kompanise eshte rivleresuar (TVSH ne shitje hipotetike te kesaj sasie te energjise) dhe nje penalitet ne masen 100% te detyrimit tatimor eshte vendosur mbi Shoqerine. Per me teper, kjo diference ne bilancin energjistik eshte konsideruar si gjeneruese e fitimit dhe per kete arsye detyrimi per tatim fitimin eshte aplikuar me nje penalitet ne masen 100% te ketij detyrimi. Ne pikepamjen e Shoqerise, supozimet e mesiperme, interpretimet dhe konkluzionet, ne menyre te qarte dhe flagrante bien ne kundërshtim me ligjin dhe perbejne nje detyrim te paligjshem dhe te palogjikshem tatimor te aplikuar mbi Shoqerine. Si pergjigje ndaj kesaj situate, Shoqeria eshte pergatitur te ndermarre te gjitha hapat ligjore te mundeshem per te kundërshtuar keto detyrime te prezumuara tatimore.

Kjo pagese prej 2.1 miliard LEK brenda nje periudhe me te shkurter se nje muaj perben nje barre financiare per Shoqerine, qe per me teper korrespondon me shumen e nevojshme te parave per te importuar energji ne rrjetin e shperndarjes per afersisht nje muaj. Si rezultat i kesaj pagese te papritur dhe te pabazuar, Shoqeria nuk ishte ne pozita te importonte energji nga fillimi i Shtatorit 2012. ERE nuk e adresoi drejt kete situate dhe ne menyre arbitrare vendosi nje penalitet tjeter per Shoqerine ne shumen e 400 milion LEK per kufizim te importeve dhe reklamoi heqjen e licences se Sherbimit te Shperndarjes se Energjise ne Tetor 2012.

Ne vazhdim, ERE refuzoi kerkesen e Shoqerise per te aprovuar nje marreveshje kredie midis CEZ Shperndarje, Bankes Europiane per Rindertim dhe Zhvillim dhe Korporates Nderkombetare te Financimit, ne formen e huase bankare ne shumen EUR 100 milion, duke penguar Shoqerine ne kryerjen e investimeve domethenese per te permiresuar rrjetin e shperndarjes se energjise gjate vitit 2012. Ne 20 Nentor 2012, Shoqeria mori nje njoftim nga ERE per fillimin e procedurave administrative te cilat mund te rezultojne ne masa te tjera administrative deri ne heqjen e licences.

Qendrimi i menaxhimit

Plani i biznesit dhe supozimet tona lidhur me likuiditetin e pershtatshem jane te bazuara ne te ardhurat e pritshme dhe kostot e ardhshme. Megjithate, te ardhurat tona mund te mos perkojne me parashikimet dhe kostot tona mund te tejkalojne parashikimet. Gjithashtu, vleresimet tona mund te ndryshojne, si dhe ngjarjet apo zhvillimet e ardhshme mund te ndikojne vleresimet tona. Ndonje nga keta faktore mund te ndryshoje pritshmerite tona lidhur me perdorimin e parase dhe ekuivalenteve te saj per vitin 2012, ose mund te ndikojne ne menyre domethenese nivelin tone te likuiditetit, qe mund te kerkoje nga ana jone te kerkojme burime te tjera financimi ose te ndermarrim masa te tjera per reduktimin e kostove operative per te siguruar vazhdimesine e aktiviteteteve. CEZ Shperndarje qendron e vendosur te vazhdoje aktivitetet e saj ne Shqiperi dhe te ofroje sherbimet me cilesore per klientet e saj, dhe te permiresoj marredheniet e saj me autoritetet lokale dhe komunitetin. Ne kete aspekt, gjate 2012, Shoqeria ka kaluar ne fazen e riorganizimit te brendshem ne menyre qe te permbushe praktikat me te mira europiane te te berit biznes.

4. Vlerësimet kritike dhe gjykime të kontabilitetit (vazhdim)

4.2 Gjykimet ne lidhje me Parimin e vijimesise (vazhdim)

Vijimesia – Evidenca per opinionin

Ne vitin 2012, Shoqeria, ne situaten e veshtire ekonomike, sic u permend me siper, ka paguar pagat e punonjesve, principalin dhe interesat e kredive afatgjata, taksat, pjesen me te madhe te shpenzimeve operacionale, dhe ka bere te gjitha perpjekjet e vazhdueshme per te paguar detyrimet qe lidhen me blerjen e energjise. Per te permiresuar likuiditetin dhe minimizuar riskun e paaftesise paguese Shoqeria ka ndermarre hapat e meposhtem gjate vitit 2012:

1. Optimizimi i kostove

- Menaxhimi i Shoqerise ka vendosur masa te reja per aprovimin e blerjeve dhe te gjitha blerjet duhet te rishikohen dhe aprovohen nga bordi i drejtoreshave qe nga Prilli 2012. Qellimi kryesor i ketij aktiviteti eshte te eliminoje blerjet e panevojshme dhe te drejtoje burimet financiare drejt aktiviteteve me vlere te shtuar per Shoqerine.
- Shoqeria ka implementuar strukture te detajuara te qendrave te kostove per te monitoruar dhe menaxhuar kostot sipas aktiviteteve me efektivisht.
- Departamentet e prokurimeve dhe faciliteteve, kane rishikuar te gjitha kontratat per sherbime te ndryshme dhe kane rinegociuar kushtet per kosto dhe terma me te mire pagese.
- I fundit por jo me pak i rendesishem, aktiviteti i Shoqerise u be pjese e procesit te buxhetimit duke implementuar planifikime dhe modele te detajuara te qendrave te kostos. Kjo perqasje e re identifikoi mundesi te reja per rritje te metejshme te eficiences dhe efikasitetit te burimeve qe perdoren dhe qarteson targetet e shpenzimeve operative ("OPEX").
- Ne vazhdimesi te kostove te shtuara ne lidhje me permiresimin e arketimeve dhe reduktimin e humbjeve te permendura me poshte, Shoqeria ka reduktuar shpenzimet operative per 3 mujorin e trete te vitit me 5 % krahasuar me vitin 2011.

2. Minimizimi i humbjeve dhe rritja e arketimeve

Gjate vitit 2012, Shoqeria ka ndermarre te gjitha masat e nevojshme per te permiresuar arketimet dhe reduktuar humbjet, te cilat kane impakt direkt ne situaten financiare te Shoqerise.

Gjate vitit 2012 (Janar – Shtator) norma e arketimeve ndaj totalit te borxhit eshte 85% krahasuar me 73% gjate vitit 2011 dhe vetem gjate tre mujorit te trete ka arritur ne masen 90%.

Shoqeria ka punuar fort dhe po perpiqet te implementoje praktikatat me te mira per te arritur objektivat e mesiperme duke:

Rritur mjetet per arketimin (SMS, telefonanta, e-mail). Ne kemi krijuar nje databaze me numrat e telefonit nga aplikacioni E-Bill dhe duke aplikuar lidhjen e databazes se Alb Telecom per kontratat e klienteve. E-mail te personalizuar, mesazhe jane derguar te konsumatorit si njoftim per detyrimet e tyre dhe statusin e detyrimeve – me teper se 100,000 kliente jane njoftuar ne baza mujore me e-mail. 155,000 SMS jane derguar cdo muaj klienteve per t'i informuar per vleren e fatures mujore dhe vleren e detyrimeve totale. Call center te disponueshme per qellime te informimit te klienteve per statusin e detyrimeve, detaje te fatures mujore dhe kalimin e afateve, po na sjellin me afer nevojave te konsumatoreve. 55,000 debitore jane kontaktuar ne baza mujore per t'u informuar ne lidhje me detyrimet.

4. Vlerësimet kritike dhe gjykime të kontabilitetit (vazhdim)

4.2 Gjykimet ne lidhje me Parimin e vijimesise (vazhdim)

Nga 140,000 deri ne 200,000 kujtesa per detyrime u jane derguar klienteve ne baza mujore, por edhe telefonatat e fundit 48 ore perpara shkeputjes se energjise per te informuar klientet ne lidhje me statusin e detyrimit te tyre, dhe detyrimin per te paguar referuar termave dhe kushteve qe parashikohen ne kontrate.

Arketare te levizshem jane te disponueshem, qe mundesojne printimin e faturave ne vend, arketimin ne vend, si dhe kreditimin e pageses ne kohe reale. Ky sherbim ofrohet me se shumti ne zonat rurale, per nje mbulim me te mire gjate diteve te pushimit, fundjavave dhe sezonit turistik.

Marreveshjet e pagesave te pjesshme jane te disponueshme per debitoret, ne menyre qe te permiresohet performanca e arketimeve dhe te ndihmohen klientet qe nuk jane ne gjendje te paguajne detyrimin e plote.

Shoqeria ka vendosur grupin NTL (Humbjet jo-teknike) te fokusuar ne shkeputjen e energjise (165 grupe me 165 makina) dhe MM (Menaxhimin e matesave) si grup i shkeputjes se energjise. Si pjese e ketij procesi disa prej ndermarrjeve te Ujesjellesve iu eshte shkeputur energjia elektrike, por gjykata e rrethit Tirane ka urdheruar te vazhdoje furnizimi me energji i ketyre enteve edhe pa likujduar detyrimet.

Impakt shume te rendesishem per mbledhjet e detyrimeve te vjetra ka edhe bashkepunimi me partnere te jashtem (Agjensi te Mbledhjes se Detyrimeve). Portofolet e agjensive te jashtme jane shperndare ne zona te ndyshme rurale dhe urbane nga veriu ne jug te Shqiperise duke perfshire nje portofol me 230,000 konsumatore debitore.

Shoqeria ka intensifikuar negociatat dhe po ushtron presion mbi qeverine shqiptare per likuidimin e detyrimeve. Shoqeria kontakton rregullisht Ministrine e Financave ne lidhje me mundesine e bllokimit te fondeve per entitete debitore. Shoqeria negocion per rakordimin e detyrimeve per te gjitha kontratat Buxhetore ose Jo-buxhetore.

Shoqeria eshte gjithashtu e fokusuar ne perdorimin e plote te proceseve gjyqesore dhe permbarimore. Shume debitore jane paditur ne gjykate dhe me pas vendimet e gjykates jane derguar ne zyrat permbarimore per t'u ekzekutuar.

Ne Korrik ka filluar nje fushate ne lidhje me nderprerjen e energjise per kabinat 100% debitore. Rilidhja e kabinave 100% debitore behet nese te gjitha kushtet e rilidhjes jane plotesuar nga klientet respektive. Ne permbushjen e qellimeve te mesiperme Shoqeria bashkepunon me qeverine lokale, policine e shtetit dhe ERE.

3. Ristrukturimi i detyrimeve

Shoqeria ka negociuar intensivisht ne amendimin e kushteve te pagesave me furnizuesit me te medhenj duke kerkuar riskedulim te pagesave per nje periudhe me te gjate kohore.

Overdraftet bankare ne bankat Societe Generale, Intesa Sanpaolo dhe Pro Credit jane rfinansuar nga nje overdraft i akorduar nga Cez A.S. Overdrafti nga Raiffeisen bank i eshte nenshtuar mekanizmave te mbledhjes nga Raiffeissen dhe do te jete ripaguar ne fund te vitit 2012.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha shumat në mijë LEK, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Vlerësimet kritike dhe gjykime të kontabilitetit (vazhdim)

4.2 Gjykimet ne lidhje me Parimin e vijimesise (vazhdim)

4. Rritja e kapitalit

Shoqëria është duke vlerësuar nevojat potenciale për të rritur kapital në mënyrë që të financojë aktivitetet e saj. Për të aderuar kërkesat e saj të rritjes së financimit Shoqëria do të kërkojë financim përmes marrëveshjeve "joint venture" dhe financim me borxh afatgjatë ose kapital. Finalizimi i këtyre çështjeve nuk mund të parashikohet në këtë moment.

5. Shuarja e detyrimeve reciproke midis CEZ Shperndarje, KESH, OST dhe të drejtave nga klientet Buxhetore dhe Jo-Buxhetore.

CEZ Shperndarje po negocion me qeverinë Shqiptare termat e një memorandumit mirëkuptimi në lidhje me mundësinë e shuarjes së detyrimeve reciproke midis pjesëmarrësve në tregun energjistik dhe institucioneve shtetërore.

Kjo marrëveshje mund të përmirësojë kapitalin qarkullues për një total 5.8 miliard LEK duke marrë në konsideratë faktin që të drejtat janë paraqitur në baza neto pas zbritjes së pjesës së kërkesave për arketim të cilesuara të paarketueshme, të llogaritura për këto të drejta. Kështu, kapitali qarkullues mund të përmirësohet nga vlera negative 11.7 miliard LEK në një vlerë negative 5.9 miliard LEK. Me poshtë ju mund t'i referoheni një tabelë me pjesën e të drejtave që duhen marrë në konsideratë në një marrëveshje të tillë:

Te drejtat

| Buxhetore & Jo - Buxhetore (Vlera kontabel bruto) | KESH (Vlera kontabel bruto) | Totali i llogarive të arketueshme |
|--|--------------------------------|--|
| 5,715,990 | 1,938,647 | 7,654,637 |

Detyrimet

| OST | KESH | Totali i llogarive të pagueshme |
|-----------|-----------|--|
| 2,811,025 | 7,055,111 | 9,866,136 |

Pas shuarjes potenciale, impakti do të jetë në një reduktim të detyrimeve nga 31 miliard LEK në 23 miliard LEK dhe në një përmirësim të rezultati vjetor nga rimarrja e provizioneve në nivelin 5.8 miliard LEK.

6. Angazhimet ne marreveshjet e borxhit

Gjatë vitit 2012, Shoqëria ka paguar të gjitha detyrimet lidhur me kredite afatgjata. Në disponojmë evidence të mjaftueshme që angazhimet e lidhura me borxhet e marra janë vlerësuar dhe cdo risk i lidhur me to është menaxhuar, kështu që këto marrëveshje nuk krijojnë risk domethenës.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.**Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011***(Te gjitha shumat ne mije LEK, pervecse kur shprehet ndryshe)***4. Vlerësimet kritike dhe gjykime të kontabilitetit (vazhdim)****4.2 Gjykimet ne lidhje me Parimin e vijimesise (vazhdim)****7. Evidenca te tjera****Plani biznesit 2012-2014**

| | 2011 Aktual | 2012 Buxhet | 2013 Buxhet | 2014 Buxhet |
|-------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Marzhi bruto | 19,519 | 876 | 7,302 | 10,745 |
| Te ardhura te tjera | 430 | 1,878 | 3,300 | 2,800 |
| OPEX pa perfshire amortizimin | (10,685) | (13,745) | (12,757) | (11,584) |
| Provizionime dhe rezerva | (8,747) | 492 | (474) | (1,854) |
| EBITDA | 517 | (10,500) | (2,629) | 107 |
| Fitimi neto | (4,487) | (15,281) | (8,689) | (6,712) |

Supozimet e planit te biznesit jane si me poshte, dhe paraqesin targete te arritshme per Shoqerine. Si nje shembull norma e arketimeve deri Shtator 2012 eshte 85% dhe tremujori i trete i vitit po arrin ne 90% duke vazhduar me tej me permiresimin e trend-it. Norma e humbjeve deri ne Shtator eshte me e larte se e planifikuara por kryesisht vjen si rezultat i humbjeve te tremujorit te pare te impaktuara nga moti i ashper. Organizimi i rrjetit te shperndarjes eshte rishikuar per te eliminuar mbi-faturimet ne rrjet dhe humbjet e larta te shkaktuara nga ky fakt. Ju lutem referojuni Shenimit 4.2 per me teper detaje mbi veprimet e ndermarra per arketimet dhe reduktimin e humbjeve.

Persa i perket cmimeve, ne nuk kemi pritshmeri per rritjen e tyre tek konsumari final.

| | 2011 Aktual | 2012 Buxhet | 2013 Buxhet | 2014 Buxhet |
|--------------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Norma e arketimit | 73% | 90% | 99% | 96% |
| Norma e humbjeve | 31% | 40% | 32% | 28% |
| Tarifa e KESH | 1,480 | 2,200 | 2,200 | 2,200 |
| Tarifa e OST | 600 | 650 | 650 | 650 |
| Tarifa mesatare e konsumatorit final | | 9,830 | 9,530 | 9,625 |

4.3. Gjykimet kritike ne aplikimin e politikave kontabel te Shoqerise*Njohja e te ardhurave*

Te ardhurat nga shitja e energjise elektrike njihen bazuar ne metoden e leximit te vazhdueshem te matesave. Te ardhurat nga klientet e pajisur me aparate matese te energjise behet ne baze te leximeve faktike te konsumit te energjise. Energjia e pafaturuar llogaritet per arsye te plotësimit të bilancit mujor të energjisë. Ajo llogaritet për çdo konsumator në mënyrë që të rritet saktësia e përlllogaritjeve. Konsumi i planifikuar deri në fund të muajit bazohet në profilin afatgjatë të OST-së për muajin në fjalë dhe korrigohet sipas kushteve të vitit aktual në bazë të një metodologjie të detajuar. Leximi i vazhdueshëm i matësve është një praktikë standarde në industrinë energjetike në vendet e perendimit dhe vendet e Bashkimit Europian. Leximi i vazhdueshëm i matësve mundëson lexuesit të bëjnë leximin e klientit mbi baza më fleksibël dhe të punojnë sipas planeve të hartuara më parë në mënyrë që të mund të lexojnë të gjithë klientët, duke larguar impaktet negative të proceseve të mëparshme të leximeve të matësve. Kushtet paraprake thelbësore për procesin e leximit të vazhdueshëm të matësve u vendosën për të përlllogaritur energjinë e pamatur. Konsumatorët do të faturohen vetëm në bazë të konsumit të matur të energjisë.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.**Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011***(Te gjitha shumat ne mije LEK, pervecse kur shprehet ndryshe)***5. Aktivet Afatgjata Materiale**

CEZ SHPERNDARJE ka vendosur te aplikojte parimin e kostos se supozuar sipas IFRS 1.16. Aktivet afatgjata materiale neto ne perdorim ne 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 eshte si me poshte:

| | 2011 | 2010 |
|--|-------------------|-------------------|
| Vlera kontabel neto e Aktiveve Afatgjata Materiale | 26,687,019 | 28,215,882 |
| Ndertime ne Proces | 247,486 | 669,682 |
| Totali | 26,934,505 | 28,885,564 |

| | Toka | Ndertesa dhe permiresimi i tokave | Makineri dhe pajisje | Aktive te tjera | Total 2011 | Total 2010 |
|---|------------------|--|-----------------------------|------------------------|--------------------|--------------------|
| Vlera Kontabel Bruto ne 01 Janar | 1,030,912 | 3,539,527 | 28,515,574 | 465,564 | 33,551,577 | 28,928,183 |
| Shtesa | - | 43,153 | 1,861,124 | 24,422 | 1,928,699 | 4,697,622 |
| Pakesime | - | - | (32,391) | (16,096) | (48,487) | (74,228) |
| Riklasifikim | - | (31) | 31 | - | - | - |
| Vlera Kontabel Bruto ne 31 Dhjetor | 1,030,912 | 3,582,649 | 30,344,338 | 473,890 | 35,431,789 | 33,551,577 |
| Amortizimi i Akumuluar ne 1 Janar | - | (347,420) | (4,749,004) | (239,271) | (5,335,695) | (2,170,555) |
| Amortizimi | - | (247,442) | (3,133,542) | (43,502) | (3,424,486) | (3,165,140) |
| Vlera Kontabel Neto e Aktiveve te nxjerra Jashte Perdorimit | - | - | (32,391) | (684) | (33,075) | (74,228) |
| Nxjerrja Jashte Perdorimit | - | - | 32,391 | 16,095 | 48,486 | 74,228 |
| Riklasifikimet | - | - | - | - | - | - |
| Amortizimi i Akumuluar ne 31 Dhjetor | - | (594,862) | (7,882,546) | (267,362) | (8,744,770) | (5,335,695) |
| AAM Neto ne Perdorim ne 31 Dhjetor | 1,030,912 | 2,987,787 | 22,461,792 | 206,528 | 26,687,019 | 28,215,882 |

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.**Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011***(Te gjitha shumat ne mije LEK, pervecse kur shprehet ndryshe)***5. Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)**

Titulli i pronesisë për token dhe ndertesat të Cez Shperndarjes, të transferuara nga KESH në momentin e ndarjes nuk ka perfunduar akoma. Shoqëria kohët e fundit i ka intensifikuar përpjekjet e saj për të marrë këto tituj pronësie, por ka mundur të zotërojë vetëm një numër të vogël në krahasim me totalin.

Në 8 prill 2008 Keshilli i Ministrave vendosi të transferojë pronësinë e pasurive të patundshme nga KESH te OSSH. Me 30 Korrik 2008, Keshilli i Ministrave aprovoi listën analitike të pasurive të transferuara nga KESH te OSSH të cilat duhet të regjistroheshin si pasuri të OSSH (1,416 faqe bashkangjitur vendimit). Lista analitike e këtyre aktiveve është pjesë e përbërës e “ Marveshjes së Shit-Blerjes”.

Si pjesë e procesit të rikonstruksionit të Regjistrimit të Aktiveve Fikse në 2009-n, Shoqëria krahasoi Regjistrin e Tokës dhe Ndertesave me listën në SAP dhe me listën në vendimin e Keshillit të Ministrave

Gjatë 2011, CEZ Shperndarje do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të përshtatur dhe regjistruar ndërtesat dhe tokat e veta në Regjistrin e Pasurisë së Patundshme sa më shpejt të jetë e mundur.

6. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Vlera neto e Aktiveve Afatgjata Jomateriale në 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 është si më poshtë:

| | Marka Tregtare dhe Licenca | Te Paprekshme ne Proces | Totali 2011 | Totali 2010 |
|---|---|--|------------------------|------------------------|
| Vlera Bruto ne 01 Janar | 21,293 | 7,067 | 28,360 | - |
| Shtesa | 48,978 | 85,812 | 134,790 | 49,653 |
| Pakesime | - | (48,978) | (48,978) | (21,293) |
| Vlera Bruto ne 31 Dhjetor | 70,271 | 43,901 | 114,172 | 28,360 |
| Amortizimi i Akumuluar ne 01 Janar | (2,404) | - | (2,404) | - |
| Shtesa | (12,736) | - | (12,736) | (2,404) |
| Pakesime | - | - | - | - |
| Amortizimi i Akumuluar ne 31 Dhjetor | (15,140) | - | (15,140) | (2,404) |
| Vlera Neto e Aktiveve Jomateriale | 55,131 | 43,901 | 99,032 | 25,956 |

Vlerat e aktiveve jomateriale i referohen licencave PDA për projektin My Avis dhe atyre të SAP-it.

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.**Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011***(Te gjitha shumat ne mije LEK, pervecse kur shprehet ndryshe)***7. Aktive Financiare**

Vlera neto e aktiveve financiare ne 31 Dhjetor 2011 dhe ne 2010 eshte si me poshte:

| | <u>2011</u> | <u>2010</u> |
|-------------------------------|----------------------|----------------------|
| Te arketueshme nga punonjesit | 25,372 | 26,705 |
| Zbritje per borxhin e keq | (14,423) | (14,423) |
| Totali | <u>10,949</u> | <u>12,282</u> |

8. Inventare

Te gjitha materialet te cilat perbejne inventarin e Shoqerise perdoren per operacionet e mirembajtjes ditore ose per ndertimin e aktiveve te reja. Per materialet e perdorura ne mirembajtje konsumi vjetor eshte rregjistruar ne llogarite kontabile perkatese te shpenzimeve.

Zhvleresimi i Akumuluar gjendje ne 31 Dhjetor 2011 ne vlere totale 519,513 mije leke lidhet me vleren e artikujve te percaktuar si njesi te cilat nuk jane me te perdorshme per Cez Shperndarjen. Kriteri per t'i klasifikuar te tilla si njesi te paperdorshme kane qene: (i) njesi te vjeteruara (ii) njesi te paperdorshme ne rjetin aktual te shperndarjes (iii) njesi te demtuara.

Inventaret perbehen si me poshte:

| | <u>2011</u> | <u>2010</u> |
|------------------------------|-----------------------|-------------------------|
| Artikuj Konsumi | 1,144,636 | 2,394,113 |
| Renie ne vlere e inventareve | (519,513) | (1,307,557) |
| Totali | <u>625,123</u> | <u>1,086,556</u> |

Levizjet ne vlere te inventareve gjate vitit jane si me poshte:

| | <u>2011</u> | <u>2010</u> |
|------------------------------|-----------------------|-------------------------|
| Ne 1 Janar | 1,307,557 | 1,463,761 |
| Renia ne vlere e inventareve | - | - |
| Rikthim i renies ne vlere | (788,045) | (156,204) |
| Ne 31 Dhjetor | <u>519,513</u> | <u>1,307,557</u> |

9. Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme te Shoqerise paraqiten si me poshte:

| | <u>2011</u> | <u>2010</u> |
|--|--------------------------|-------------------------|
| Llogari te arketueshme | 46,396,796 | 34,807,294 |
| Minus : zbritje per llogarite e arketueshme | (33,557,662) | (27,902,896) |
| Vlera neto e llogarive te arketueshme | <u>12,839,134</u> | <u>6,904,398</u> |

CEZ SHPËRNDARJE SH.A.**Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011***(Te gjitha shumat ne mije LEK, pervecse kur shprehet ndryshe)***9. Llogari te arketueshme (vazhdim)**

Llogarite e arketueshme te Shoqerise perbehen nga faturat e papaguara te energjise elektrike.

Nje prezantim sipas kategorive te klienteve i vlerave te papaguara te llogarive te arketueshme ne 31 Dhjetor 2011 paraqitet si me poshte:

